

Fjalimi i Z. H. Bujar Spahiu,

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë,

11 qershor 2019

Feja dhe prijësit fetarë gjithmonë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në shoqëri. Myslimanët shqiptarë bashkë me prijësit e feve të tjera kanë qenë faktor kyç në formësimin e identitetit kombëtar. Në çdo hap të rëndësishëm të vendit tonë si Lidhja e Prizrenit, Pavarësia e Shqipërisë, etj., ata kanë qenë mbështetësit e parë dhe në shumë raste edhe iniciues të lëvizjeve kombëtare dhe shtet formuese.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë u themelua pikërisht nga rilindas dhe firmëtarë të pavarësisë 96 vjet më parë, si një bashkësi, që do të përfaqësonte zërin e besimtarëve myslimanë në Shqipëri dhe në trojet shqiptare.

Ky institucion, që në vitet e para të formimit të vet e deri më sot ka qenë promovues i edukatës dhe moralit të lartë shoqëror, i besës, mikpritjes, bujarisë, harmonisë dhe bashkëjetesës etnike dhe fetare në vend.

Fryma e besimit i mëson njeriut që të jetë respektues me të tjerët, pranues i të ndryshmes, dhe të jetë bashkëpunues me qëllimin e përbashkët për zhvillimin e shoqërisë, emancipimin, integrimin dhe edukimin e saj.

Komuniteti Mysliman në aktivitetin e tij institucional i ka lënë një rol të rëndësishëm edukimit dhe arsimit. Ne besojmë fort se edukimi dhe arsimimi i brezit të ri me dije shkencore dhe fetare do të jetë një faktor i rëndësishëm në stabilizimin dhe zhvillimin e shoqërisë. Duke patur parasysh këtë fakt KMSH ka në mbarëvajtje dhe ndjekje institucionale medrese në disa qytete kryesore të vendit, si Tiranë, Elbasan, Korçë, Shkodër, Kavajë dhe Durrës, si dhe Universitetin Bedër, themeluar në vitin 2011.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë sot ka një rol të rëndësishëm institucional në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit social, edukativ, moral dhe të bashkëjetesës ndërfaqetare.

Sot, përfaqësuesit e komuniteteve fetare në Shqipëri, ndjehen shumë krenarë për këtë pasuri të vyer që na kanë trashëguar nga paraardhësit tanë, dhe e konsiderojmë si një detyrë tepër madhore ruajtjen e kësaj pasurie, duke u angazhuar maksimalisht për ta forcuar dhe për tua përcjell atë edhe brezave të ardhshëm.

Komunitetet fetare kanë patur gjithmonë raporte të bazuara në vlerat morale, dashurinë, paqen, dhe harmoninë mes njerëzve. Nisur nga kjo, në vazhden e bashkëpunimit mes komuniteteve tona, duke menduar edhe zhvillimet kohore, para 11 vitesh themeluan organizatën “Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë” me qëllim që të promovojmë vlerat dhe parimet tona fetare në ndërtimin e një shoqërie më paqësore dhe më të drejtë, duke u bërë një model social, kulturor dhe profesional për popullin tonë, si dhe më gjerë. Gjithashtu, ne besojmë fort, se në raste të shqetësimit të përbashkët, zëri i komuniteteve fetare në mbrojtjen e të drejtave të individëve apo më gjerë, është më ndikues dhe më serioz në zgjidhjen e çështjeve në Shqipëri.

Vlen të theksohet se KMSH përveç bashkëpunimit me komunitetet fetare në vend, ka një bashkëpunim të ngushtë me Bashkësitë Islame dhe me komunitetet e tjera fetare të rajonit dhe më gjerë. Vlen të përmenden disa prej bashkëpunimeve të konkretizuara gjatë viteve të fundit siç janë konferencat, botimet e përbashkëta si dhe marrëveshje të ndryshme midis bashkësive në promovimin e vlerave dhe në shkëmbimin e eksperiencave të cilat jo vetëm që forcojnë marrëdhëniet tona por edhe unifikojnë më së

miri angazhimin tonë në ruajtjen e vlerave të përbashkëta fetare, morale dhe kombëtare. Duke marrë shkas nga kjo, unë besoj fort se ky bashkëpunim do të ndikojë fort në rrugën e vendeve të rajonit drejt integritit në bashkimin evropian.

KMSH, edhe meqenëse sot vuan akoma nga problemet e trashëguara nga vitet e errëta të komunizmit si mos kthimi i pronave dhe uzurpimi i një pjese tjetër, vazhdon me insistim të intensifikojë bashkëpunimin jo vetëm me institucionet e vendit por edhe më gjerë. Ne i kemi të qarta detyrat dhe përgjegjësitë që na bien në rrugën e ruajtjes së vlerave të besimit, moralit, dashurisë për atdheun si dhe integritimin dhe emancipimin e kombit tonë.